ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **33600-25-5147-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Servisim dhe mirëmbajtja e pajisjeve të klimatizimit të SHKK-së, IML-së, MD-së dhe SHSK-së**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**AS Tech SH.P.K.**
NUI	**601262611**
Adresa	**AHMET KRASNIQI**
Vendi	**PRISHTINË**
Kodi postar	**-**
Numri Telefonit	**044770161**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**AFRIM SADIKU**
Adresa elektronike	**shpk.astech@gmail.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**01.07.2025**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Servisim dhe mirëmbajtja e pajisjeve të klimatizimit të SHKK-së, IML-së, MD-së dhe SHSK-së

Njoftimi per kontrate-10.06.2025

Kerkese epr sqarim te dosjes se tenderit - 13.06.2025

Pergjigja e Kerkeses per sqarime-18.06.2025

Kerkese per rishqyrtim - 20.06.2025

Vendimi ndaj kerkeses per rishqyrtim - 27.06.2025

Ankesa ne OSHP- 01.07.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Ne sistem

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 - Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

2. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jodiskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji.

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 32 Rregullat e Përgjithshme

Neni 27 Dosja e Tenderit

Neni 40 Njoftimi i Kontratës

Rregullat per trajtim te Kerkeses per rishqyrtim

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Paraqesim ankesë kundër Njoftimit për Kontratë të Autoritetit Kontraktues (AK), lidhur me procedurën me titull "Servisim dhe mirëmbajtja e pajisjeve të klimatizimit të SHKK-së, IML-së, MD-së dhe SHSK-së", me numër prokurimi 33600-24-11868-2-2-1.

Pretendimi 1: Ashpërsim i Pajustifikueshëm i Kriterëve Teknikë dhe Pengim i Konkurrencës së Lirë
Në këtë procedurë të ritenderuar, e cila pason procedurën paraprake të anuluar pë të njëjtin aktivitet të prokurimit të datës 04.12.2025 (e cila u anulua për shkak të mungesës së ofertave të përgjegjshme), AK ka shpallur sërish tenderin për të njëjtin aktivitet. **Megjithatë, në mënyrë të pajustifikueshme dhe selektive, janë ashpërsuar kriteret e kapacitetit teknik në Dosjen e Tenderit**, duke vendosur kushte të reja e më të rënda, që nuk përfaqësojnë ndonjë nevojë objektive shtesë dhe që e bëjnë të pamundur konkurrencën e drejtë dhe të barabartë.

Konkretisht, kërkesa e re është si vijon:

- **Kërkesa:** Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën një (1) Inxhinier të diplomuar të Makinerisë, drejtimi Termoenergjitikë – Termoteknikë, i cili duhet të jetë edhe auditor i certifikuar për efiçiencë të energjisë.
- **Dështmia:**
    - Diploma e Inxhinierit të Makinerisë dhe Certifikata për auditor të energjisë efiçente.
    - Kopje e kontratës së punës ose para-kontratë e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët.

Ndërkohë, në procedurën e parë të anuluar, **kërkesat ishin dukshëm më të arsyeshme dhe proporcionale** me objektin e kontratës:

- **Kërkesa (e mëparshme):** Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar të paktën një (1) Inxhinier të diplomuar të Makinerisë, drejtimi Termoenergjitikë me Termoteknikë.
- **Dështmia:**
    - Kopje e noterizuar e diplomës, kontrata e punës ose para-kontrata. Noterizimi i diplomës nuk duhet të jetë më i vjetër se 30 ditë nga data e hapjes së ofertave.

Pjesët e shënuara me ngjyre te kuqe lartë përfaqësojnë kritere shtesë të shtuara në mënyrë të pajustifikueshme nga Autoriteti Kontraktues (AK) në procedurën e ritenderuar.
Pikërisht ky ndryshim i pajustifikuar dhe përjashtues në kriteret teknike është objekt i kësaj ankese. Përfshirja e domosdoshmërisë së certifikatës së auditorit të energjisë në fazën e tenderimit nuk ka bazë të arsyeshme dhe krijon kushte të pabarabarta për operatorët ekonomikë, duke vënë në pikëpyetje qëllimin dhe integritetin e procesit të prokurimit.

Është absurde dhe në kundërshtim flagrant me logjikën dhe parimet e prokurimit publik që një procedurë të ritenderohet me kritere më të ashpra, kur ajo paraprake është anuluar për shkak të mungesës së ofertave të përgjegjshme. Në vend që AK të mbajë të njëjtat kushte ose t'i lehtësojë ato për të nxitur konkurrencën dhe pjesëmarrjen, ka zgjedhur të shkojë në drejtim të kundërt – **duke shtuar barriera të reja, të pajustifikuara dhe diskriminuese.**
Ky veprim jo vetëm që është i papërgjegjshëm profesionalisht, por përbën shkelje të drejtpërdrejtë të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), përkatësisht **nenit 7 – Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi**, duke kufizuar hapur konkurrencën dhe duke favorizuar në mënyrë selektive operatorë të caktuar.
Shkeljet ligjore të evidentuara përfshijnë:
Neni 7 – Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi

- **Paragrafi2:**
  "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik."
  → **Vendosja e kritereve shtesë dhe kufizuese është pikërisht reduktim i konkurrencës.**
- **Paragrafi3:**
  "Autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet [...] të vendosë një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes [...] që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik."
  → **Kriteret e shtuara nuk përfaqësojnë ndonjë nevojë reale të aktivitetit të prokurimit, por janë të dizajnuara për të kufizuar qasjen.**
- **Paragrafi4:**
  "Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë [...] kushte që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik."
  → **Pikërisht kjo është ajo që ndodh me këtë ndryshim të kritereve.**

Me këtë veprim, AK e ka cenuar rëndë parimin e barazisë dhe të konkurrencës së lirë, duke vënë në pikëpyetje integritetin dhe ligjshmërinë e të gjithë procesit të prokurimit. Nëse një procedurë dështoi për shkak të mungesës së konkurrencës, vendosja e kushteve edhe më të rrepta është jo vetëm veprim i

pajustifikueshëm, por tregues i qartë i **tentativës për manipulim të qëllimshëm të procesit të përzgjedhjes.**
Vendosja e kërkesës për staf të certifikuar si auditor i energjisë në këtë procedurë është krejtësisht e papërshtatshme, joproporcionale dhe e pabazuar në realitetin teknik dhe ligjor të kontratës.
Në këtë rast kemi të bëjmë me një procedurë që ka për objekt shërbime standarde të mirëmbajtjes dhe servisimit të pajisjeve klimatike – aktivitete që zakonisht kryhen nga teknikë mekanikë apo serviserë të pajisjeve, dhe nuk përfshijnë as projektim energjetik, as instalim të sistemeve të reja, e aq më pak kërkesë për ekspertizë në auditim të energjisë.
Përfshirja e një audituesi të energjisë është jo vetëm e tepruar, por edhe teknikisht e pakuptimtë.
Aktivitetet tipike të këtij shërbimi përfshijnë:

- Pastrim të filtrave të klimës,
- Mbushje me gaz ftohës,
- Zëvendësim i pjesëve të dëmtuara,
- Kontroll funksional dhe mirëmbajtje periodike.

Asnjë nga këto aktivitete nuk kërkon trajnim apo certifikim si auditor i energjisë. Kërkesa për një profesionist të tillë është krejtësisht jashtë kontekstit teknik dhe praktik të shërbimit, dhe si e tillë, përbën një kriter diskriminues dhe përjashtues, që nuk ka asnjë lidhje reale me përmbushjen e kontratës.

Përgjigjet e Autoritetit Kontraktues (AK) vetëm sa thellojnë absurditetin e situatës
Në kërkesën tonë për sqarime të dosjes së tenderit, AK ka dhënë një përgjigje të papranueshme, duke pretenduar se kërkesa për auditor energjie "ka të bëjë me furnizimin me pajisje efiçente." Po ashtu, në përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim, AK përsërit të njëjtën arsyetim, duke pohuar se nevojitet auditor për shkak se kemi të bëjmë me pajisje efiqente.
Kjo përgjigje është jo vetëm joprofesionale dhe e pabazë, por edhe qesharake në aspektin teknik. Nuk është nevoja për auditor të energjisë për të blerë apo montuar ose servisuar një pajisje klimatike efiqente. Çdo pajisje e këtij lloji ka të deklaruar qartë klasën e saj të efiqences energjetik në paketim (p.sh. A+++, A++), dhe kjo është informacion i lexueshëm për çdo punëtor te thjeshtë teknik, pa pasur nevojë për ndonjë analizë apo ekspertizë të thelluar.
Për më tepër:

- Audituesi i energjisë nuk është as person që realizon montimin apo servisim të pajisjeve klimatike.
- Klasa e efiqences energjetike nuk ndryshon mënyrën e montimit – një klimë me A+ montohet në të njëjtën mënyrë si një klimë me A+++, nje Teknik njesoj e monton nje klime me A+ dhe njesoj nje klime me A+++.

Kërkesa për angazhimin e një audituesi energjie në një procedurë të thjeshtë mirëmbajtjeje dhe servisi është:

- Teknikisht e pajustifikuar,
- Ligjërisht e pambështetur,
- Logjikisht e paarsyeshme,
- Dhe praktikisht diskriminuese, duke përjashtuar operatorë që janë realisht të kualifikuar për të realizuar kontratën.

Ky kriter duhet të largohet menjëherë nga dosja e tenderit, pasi cënon rëndë barazinë në trajtim dhe shkel në mënyrë të hapur parimet themelore të prokurimit publik, përkatësisht nenin 7 të LPP-së. Çdo justifikim që tenton të arsyetojë një kriter të tillë bie ndesh me standardet profesionale dhe përbën pengesë të drejtpërdrejtë për konkurrencë të ndershme në treg.
Me poshte do ta shtjellojme se a eshte i nevojshem nje auditor i energjise per ekzekutim te projektve klimatike sipas te dhenave nga internet.

Prova 1 – Sqarim nga interneti (ChatGPT): A kërkohet auditor i energjisë për projekte të furnizimit dhe servisimit të klimave?

ChatGPT

per montim te klimave a ehste i nevojshem auditori i certifikuar per energji?

Jo, për **montimin e klimave (kondicionerëve) nuk është i nevojshëm** një **auditor i certifikuar për energji.**

Ja dallimi i qartë:

Aktiviteti	Kush është i nevojshëm?
Montimi i klimave / kondicionerëve	Teknik i certifikuar për sisteme HVAC ose frigoriferike
Auditimi energjetik	Auditor i certifikuar për energji

Pra, për montim të klimave:

- Kërkohet zakonisht një **teknik ose instalues i certifikuar** për pajisje të ftohjes dhe ngrohjes (HVAC).
- Në disa raste, ai duhet të ketë licencë për **trajtim të gazrave ftohës** (p.sh. gazet si R-410A, R-32), për shkak të rregullave të mjedisit dhe sigurisë.

Kur hyn në lojë auditori i energjisë?

- Kur doni të **analizoni nëse klima që do instaloni është efikase** për objektin tuaj.
- Kur doni një **projekt energjetik më të gjerë**, ku përfshihen izolimi, ndriçimi, ngrohja, ftohja, etj.
- Për objekte të mëdha, si **shkolla, spitale, institucione publike apo ndërtesa biznesi**, ku kërkohet **audit energjetik** para investimeve në sistemet HVAC.

Sipas sqarimeve të qarta dhe zyrtare nga burime të besueshme në internet, përfshirë edhe analizën e ChatGPT, për furnizimin dhe servisimin e pajisjeve klimatike kërkohen teknikë ose instalues të certifikuar, dhe jo auditorë të energjisë, siç e ka kërkuar Autoriteti Kontraktues në vendimin e tij për rishqyrtim.
Është e qartë se roli i auditorit të energjisë hyn në lojë vetëm në fazën e analizës dhe projektimit të sistemeve klimatike, pra **para se të fillojë implementimi apo analiza e nje plani per projekte te instalimeve klimatike** dhe jo gjatë ekzekutimit të punimeve teknike si servisim apo instalim. Kjo është një praktikë e njohur dhe e pranuar ndërkombëtarisht dhe ligjërisht.

Autoriteti Kontraktues, megjithatë, duket se ka zgjedhur që të vendosë kërkesa të padrejta dhe të papërputhshme me natyrën reale të procedurës, me qëllim të dukshëm uljen e konkurrencës dhe përjashtimin e operatorëve ekonomikë të caktuar, përfshirë edhe kompaninë tonë.
Ky qëndrim nuk është i rastësishëm, pasi AK tashmë ka njohuri të thella nga procedura paraprake e anuluar se cilet jane Operatoret ekonomik potencial per te ofertuar si rasti i Kompanise tone "As tech", dhe pa dashur të jemi subjektivë, duket se AK ende mban një qëndrim personal negativ ndaj kompanisë tonë për shkak të mosmarrëveshjeve në kontratën e kaluar, nga e cila ne kemi kërkuar ndërprerjen e kontratës për arsye të qarta.

Megjithatë, pavarësisht qëndrimeve tona të kaluara, fakti që AK ka treguar një sjellje jo profesionale, tendencioze dhe joproporcionale në këtë procedurë ritenderimi është i mjaftueshm per te gjykuar tendencen dhe papergjegjshmerine e AK-se në këtë procedure të prokurimit.
Në praktikën e prokurimit publik, nuk është parë asnjëherë më parë që një Autoritet Kontraktues të imponojë kritere të tilla tejet të ashpra, të panevojshme dhe diskriminuese, për një procedurë të thjeshtë si servisim dhe furnizim i pajisjeve klimatike aq me pak te shtoje kritere ne procedure te ritenderimit..
AK ka cenuar rëndë parimin e barazisë dhe konkurrencës së lirë, duke vënë në dyshim integritetin e procesit të prokurimit. Vendosja e kushteve më të rrepta pas një dështimi për mungesë konkurrence është e

papranueshme dhe tregon për manipulim të qëllimshëm të procesit.
Ky ndryshim arbitrar duhet të anulohet menjëherë për të garantuar konkurrencë reale dhe respektimin e Ligjit për Prokurimin Publik.

Pretendimi 2: Vonesë e Papranueshme dhe Shkelje e Afateve Ligjore nga Autoriteti Kontraktues

Autoriteti Kontraktues (AK) ka vonuar në mënyrë të papranueshme trajtimin e kërkesës sonë për rishqyrtim, e dorëzuar më 20.06.2025, ndërsa shqyrtimi është bërë vetëm më 27.06.2025, duke shkelur qartë afatet dhe procedurat e përcaktuara nga Ligji për Prokurimin Publik.

Për më keq, AK nuk ka dhënë asnjë sqarim apo arsye për këtë vonesë të paarsyeshme, duke tentuar të zvarrisë procesin dhe të pengojë trajtimin në kohë të ankesës sonë.

Ne kemi vepruar plotësisht në përputhje me ligjin dhe kërkojmë pezullimin urgjent të procesit të prokurimit, për të garantuar trajtim të drejtë të ankesës dhe për të parandaluar hapjen e tenderit më 02.07.2025 pa adresuar më parë shqetësimet tona ligjore.

Kërkesë:

Kërkojmë trajtim urgjent të çështjes, anulimin e kritereve diskriminuese dhe rikthimin e barazisë dhe ligjshmërisë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Në bazë të parimeve dhe dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), kërkojmë nga Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP) që:

- Të aprovojë ankesën tonë,
- Të urdhërojë Autoritetin Kontraktues (AK) që të respektojë në mënyrë rigoroze të gjitha nenet e Ligjit për Prokurimin Publik,
- Të bëjë korrigjime të menjëhershme në procedurën aktuale, duke rishikuar kërkesat e vendosura në kapitullin "Kapaciteti Teknik dhe Profesional" të dosjes së tenderit.

Në veçanti, kërkojmë që AK të përcaktojë kritere që janë:

- Të drejta dhe të paanshme,
- Të matshme dhe të dokumentueshme,
- Të arsyeshme dhe në përputhje me natyrën e shërbimeve që do të ofrohen,
- Pa asnjë qëllim për të kufizuar apo diskriminuar operatorë ekonomikë të caktuar apo në përgjithësi.

Ky rishikim është i domosdoshëm për të garantuar një proces prokurimi të hapur, transparent, të drejtë dhe me konkurrencë të barabartë, në përputhje me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Te papercaktuara

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*